



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2017 – Numri: 244

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 16 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10702, datë 26.12.2017	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 13419
Udhëzim i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 29.12.2017	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”..... 13419
Udhëzim i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 30, datë 29.12.2017	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 44, datë 21.8.2013, “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”..... 13420
Udhëzim i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 29.12.2017	Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë..... 13423
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 88, datë 28.12.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2017-304, datë 7.4.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 73, datë 10.5.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 11, datë 9.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan..... 13436
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 89, datë 28.12.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 48, pika 2, shprehja “si dhe tarifën e mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit On-line që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara” dhe të nenit 70, pika 12, shprehja “tarifa e mirëmbajtjes së tij që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara”, të ligjit nr. 155, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

	Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të fjalisë së fundit të pikës 1 të dispozitave të përgjithshme dhe të pikave 2 dhe 3, të kreut VI të VKM-së nr. 647, datë 14.9.2016, “Për përcaktimin e mënyrës dhe kritereve të përzgjedhjes të operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit On-line (SQMO), si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”.	
	Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të pikës 1, të VKM-së nr. 331, datë 12.4.2017, “Për miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit On-line (SQMO) që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara”, në lidhje me tarifat e mirëmbajtjes për kategorinë baste sportive.....	13440
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 51, datë 23.11.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Devoll.....	13447
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 52, datë 23.11.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Mirditë.....	13448
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 53, datë 23.11.2017	Për licencimin për herë të parë të sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Roskovec.....	13448
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 54, datë 15.12.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Kolonjë.....	13448
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasit Elidon Ndrio	13449
	Kërkesë për deklarimin e vdekjes së shtetasit Edmond Memaj.....	13449

**DEKRET**

Nr. 10702, datë 26.12.2017

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Gentian Thoma Balukja
2. Arqilea Thanas Fuqi
3. Elsa Thodhoraq Fuqi (Mihallari)
4. Athanasios (Athanasios) Arqilea (Ahilleas) Fuqi
5. Stella Arqilea (Ahilleas) Fuqi
6. Miranda Bajo Goroviq (Nikollaj/Krstoviq)
7. Bledjan Hamdi Çera
8. Amanda Tahir Sibold (Koçi)
9. Branko Bogiq Vuçiq (Jugu)
10. Marko Ilia Lito
11. Lorenc Ilia Lito
12. Ajtena Rexhep Tafaj
13. Erzim Ylli Veshi
14. Sherife Bajram Selita (Pojana)
15. Nensi Haki Selita
16. Nertila Sefer Doda (Duka)
17. Lea Lucia Edi Doda
18. Miroslav (Miroslav) Zelinko Brajović (Jakoja)
19. Paula Vladimir Aliu
20. Emiljana Ismail Mihola (Kaziu)
21. Christovalantis Sotiraq (Sotiraki) Chatzini
22. Jonilda Xhevahir Shotani (Krasniqi)
23. Stella Emergin (Emergin Muharem) Shotani
24. Paola Maciej Piotr Czugalińska
25. Alexander Maciej Piotr Czugaliński

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM

Nr. 29, datë 29.12.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 15, DATË 12.7.2013, “PËR
PROCEDURAT E POSAÇME PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR
LICENCË TË INSTITUCIONEVE
ARSIMORE PRIVATE DHE
INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PLOTËSUESE PRIVATE
PARAUNIVERSITARE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 15, 16, pika 4, neni 17, pika 3, germa “d” dhe nenit 20 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 4 të kreut I, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, gerrat “b”, “c” “e” dhe “f”, shfuqizohen.

2. Në pikën 4 të kreut I, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, germa “g”, ndryshon si më poshtë:

“g. Shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi”.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Lindita Nikolla**



Shtojca 1

KËRKESË PËR LICENCIMIN E
 INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE
 DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE
 PLOTËSUESE PRIVATE
 PARAUNIVERSITARE

Institucioni arsimor privat parauniversitar: _____

Kërkuesi i licencës: _____

Vendndodhja: _____

Adresa elektronike e institucionit: _____

Numër kontakti: _____

I. AUTODEKLARIM

Ne/unë i/e nënshkruari/a _____

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Të gjitha të dhënat janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë penale në rast dhënie informacioni të pavërtetë, si dhe pranoj t'i nënshtrohem verifikimit nga organet përkatëse për të gjithë informacionin e paraqitur si më poshtë:

1. Subjekti që aplikon për licencë, garanton se drejtuesi didaktik dhe personeli mësimdhënës disponojnë dokumentacionin arsimor (diplomë, listë notash, licencë për ushtrimin e profesionit) në përputhje me profilin e lëndës përkatëse.

2. Subjekti që aplikon për licencë disponon kontratën e punës me kohë të plotë ndërmjet tij dhe drejtuesit didaktik.

3. Subjekti që aplikon për licencë, garanton zbatimin e kurikulës zyrtare (Plane mësimore, programe lëndore dhe tekste mësimore) të miratuara nga MASR.

4. Subjekti që aplikon për licencë, garanton listë të plotë të stafit drejtues dhe mësimdhënës me ngarkesën mësimore përkatëse.

5. Subjekti që aplikon për licencë, garanton bazën materiale dhe atë didaktike që do të vihet në dispozicion (inventarin përkatës) dhe që është në funksion të arsimit, edukimit dhe realizimit të kërkesave të programeve lëndore.

Subjekti

Data _____

Firma

UDHËZIM

Nr. 30, datë 29.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË
 UDHËZIMIN NR. 44, DATË 21.8.2013,
 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
 DHE PROCEDURAVE TË
 NJËVLERSHMËRISË SË DËFTESAVE
 DHE DIPLOMAVE TË NXËNËSVE TË
 ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË
 ARDHUR NGA JASHTË VENDIT”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, pika 2, germa “a” dhe të pikës 4, të nenit 52 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në kreun 2 të udhëzimit nr. 44, datë 21.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 3 e germës I ndryshon si më poshtë:

“3. Dokumentet, që paraqiten pranë DAR/ZA-së për njëvlershmërinë, janë:

a) Kërkesë për njëvlershmërinë dhe deklaratë me shkrim e prindit.

b) Dokumentet e vijueshmërisë së klasës, të përkthyer dhe të noterizuara, të pajisura me vulë apostile të shtetit nga vijnë.”.

b) Pika 3 e germës II ndryshon si më poshtë:

“3. Dokumentet, që paraqiten pranë DAR/ZA-së për njëvlershmërinë, janë:

a) Kërkesë për njëvlershmërinë dhe deklaratë me shkrim e prindit.

b) Dokumentet e vijueshmërisë së klasës, të përkthyer dhe të noterizuara, të pajisura me vulë apostile të shtetit nga vijnë.”.

2. Kreu 3 i udhëzimit nr. 44, datë 21.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:



“KREU 3

KRITERET DHE PROCEDURAT E
NJËVLERSHMËRISË SË DIPLOMAVE TË
ARSIMIT TË MESËM TË LARTË

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) kryen procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave /diplomave të arsimit të mesëm të lartë për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit, për vijimin e studimeve në arsimin e lartë dhe për punësimin.

2. Njëvlershmëria e dokumentacionit, për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit që duan të ndjekin studimet në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në Republikën e Shqipërisë dhe atyre për punësim bëhet gjatë gjithë vitit.

3. Njëvlershmëria e dëftesave/diplomave të arsimit të mesëm të lartë për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit, për Maturën Shtetërore dhe për punësimin realizohet nga Komisioni i Posaçëm, i ngritur në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

4. Nxënësit e ardhur nga jashtë vendit, të cilët duan të vijnë studimet në IAL-të në vendin tonë, duhet të dërgojnë përmes shërbimit postar ose të dorëzojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore dokumentet si më poshtë:

a) Formulari i aplikimit (aplikanti mund ta shkarkojë *on-line*).

b) Diplomë dhe dëftesat me listë notash e të gjitha viteve të shkollimit, të përkthyer nga një përkthyes i licencuar dhe të noterizuara, të pajisura me vule apostile të shtetit nga vijnë.

5. Dokumentacioni për njëvlershmërinë për punësim në Republikën e Shqipërisë dërgohet përmes shërbimit postar ose dorëzohet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, nga aplikanti ose nga institucioni i interesuar punëdhënës.

6. Dokumentet për njëvlershmërinë për punësim janë:

a) Formulari i aplikimit për njëvlershmëri (aplikanti mund ta shkarkojë *on-line*).

b) Kopja e përkthyer dhe e noterizuar e diplomës, që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit, i pajisur me vule apostile.

7. Dokumentet e dorëzuara për njëvlershmëri, për rastet e përcaktuara në pikat 4 dhe 6 të këtij

Udhëzimi, shqyrtohen nga Sekretariati Teknik i Komisionit të Posaçëm.

8. Sekretariati Teknik i Komisionit të Posaçëm paraqet për vendimmarrje në Komisionin e Posaçëm vetëm dokumentet/aplikimet për njëvlershmëri, që rezultojnë të plotësuara sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 4 dhe 6 të këtij udhëzimi. Kur Sekretariati vëren mangësi në dokumente/aplikim, i kthen përgjigje me shkrim aplikantit, duke specifikuar arsyet pse nuk i njëvlerësohet dokumenti i shkollimit.

9. Komisioni i Posaçëm, për nxënësin e ardhur nga jashtë vendit që do të ndjekë studimet në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në Republikën e Shqipërisë, brenda 5 (pesë) ditëve shqyrton dhe harton dokumentin e njëvlershmërisë, për nxënësin, në të cilin përcaktohen:

a) Indeksi i shkollës së kryer;

b) Nota mesatare për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë;

c) Notat e njëvlerësuar me provimet e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë;

d) Nota mesatare e përgjithshme, e njëvlerësuar.

10. Njëvlershmëria e rezultateve të arritura në shtetin përkatës të kryhet në përputhje me tabelën bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi (shtojca 1).

11. Komisioni i Posaçëm njëvlerëson lëndën, e cila përcakton njohuritë gjuhësore dhe letrare të shtetit nga vjen nxënësi, me lëndën/lëndët “Gjuhë shqipe dhe letërsi”.

12. QSHA-ja, mbështetur në vendimin e Komisionit të Posaçëm, pajis nxënësin e ardhur nga jashtë vendit me dokumentin e njëvlershmërisë. Ky dokument miratohet /nënshkruhet nga drejtuesi i QSHA-së dhe lëshohet në dy kopje origjinale.”

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Zhvillimit të Programeve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Lindita Nikolla



Shtojca 1

TABELA E KONVERTIMIT TË NOTAVE

Shteti	Klasat	Notat						
Shqipëria	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Greqi	1-4	4.00-4.90	5.00-6.49			6.50-8.49		8.50-10.00
	5-6	-	5	6	7	8	9	10
	7-12	7-9	10	11-12	13-14	15-16	17-18	19-20
Kosovë, Mali i Zi,	1-5	1	2	-	3	4	-	5
Maqedoni Serbi, Slloveni	6-9	1	2	-	3	4	-	5
	10-12	1	2.00-2.99		3.00-3.99		4.00-4.99	5.00
Itali	1-13	5.99	6.00-6.99		7	8	9	10
Turqi	1-12	25-44	45-54		55-69		70-84	85-100
	1-12	1	2.00-2.99		3.00-3.99		4.00-4.99	5
Gjermani, Austri	1-10	6.00	5.00	4.00	3.00		2.00	1.00
	11-13	6.00	5.00	4.00	3.00		2.00	1.00
SHBA, Mbretëri e Bashkuar	1-9	F	D		C		B	A
	10-12	F	D		C		B	A
	%	34	35-37		38-49		50-63	64-100
Bullgari	1-9	2.00-2.99	3.00-3.99		4.00-4.99		5.00-5.99	6.00
	10-12	2.00-2.99	3.00-3.99		4.00-4.99		5.00-5.99	6.00
Poloni	1-9	1	2		3		4	5-6
	10-12	1	2		3		4	5-6
Rumani	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Francë	1-12	-7.99	8.00-9.99	10.00-11.99	12.00-13.99	14.00-15.99	16.00-17.99	18.00-20.00
Belgjikë (flemish)	1-12	-7.99	8.00-9.99	10.00-11.99	12.00-13.99	14.00-15.99	16.00-17.99	18.00-20.00
Belgjikë (french)	1-12	-9.99	10-11.99	11-12.99	13-15.99	16-17.99	18-19.99	20
Luksemburg	1-12	-19.99	20-29.99	30-39.99		40-49.99		50-60
Zvicër	1-12	-3.99	4-4.49		4.50-4.99		5-5.49	5.50-6
Norvegji	1-12	1	2		3		4	5-6
Holandë	1-12	4-5.49	5.50-5.99	6-6.49	6.50-7.49	7.50-8.49	8.50-9.49	9.50-10
Finlandë	1-12	4-4.99	5	6	7	8	9	10
Spanjë	1-12	4	5	6	7	8	9	10
Danimarkë	1-12	-1.99	2-3.99	4-6.99		7-9.99		10-12
Egjipt	1-12	0-49%	50-64%		65-74%		75-100%	

Shënime.

- Konvertimi i notave bëhet në mënyrë të përkallëzuar, duke krahasuar sistemin e vlerësimit në shtetin që ka lëshuar dokumentin shkollor me sistemin e vlerësimit në Republikën e Shqipërisë.
- Shembull ilustrues 1: nëse në dokumentin shkollor të lëshuar në Francë vlerësimi në një lëndë është 15.00, nota sipas sistemit tonë del 8.50; nëse nota nga Franca do të ishte 14.75, nota sipas sistemit tonë do të jetë 8.37.
- Shembull ilustrues 2: nota 4 e Kosovës, sipas sistemit tonë del 8.00; nota 4.7, po e Kosovës, sipas sistemit tonë del 9.40.
- Për shtete të tjera që nuk pasqyrohen në këtë tabelë, konvertimi bëhet me sistemin më të përafërt, duke shkarkuar sistemin e vlerësimit të shtetit përkatës nga faqet zyrtare në internet.

**UDHËZIM**

Nr. 31, datë 29.12.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,
DOKUMENTACIONIT DHE
PROCEDURAVE PËR HAPJEN,
RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E
PROGRAMEVE TË STUDIMIT NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË**

Në mbështetje, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 35 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:**KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) depoziton në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR) dokumentacionin dhe formularin sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për hapjen dhe/ose riorganizimin e një ose disa programeve studimi. Afati i fundit i depozitimit është data 30 nëntor, për vitin akademik pasardhës.

2. Hapja dhe/ose riorganizimi i një ose disa programeve studimi bëhet duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave për njohuri, aftësi dhe kompetenca në tregun e punës, si edhe duke u provuar nga ana e subjektit se është në gjendje të ofrojë garancitë e nevojshme akademike e infrastrukturore dhe mbështetjen e nevojshme financiare për veprimtarinë e kërkuar.

3. Miratimi i hapjes së programeve të studimit bëhet kur plotësohen kriteret infrastrukturore, organizative dhe ato të lidhura me personelin akademik që do të përfshihet në realizimin e disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese. Hapja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit të MASR-së, pas plotësimit të kriterëve dhe kërkesave ligjore në fuqi.

KREU II**DOKUMENTACIONI PËR HAPJEN E
PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT
PËR TË GJITHA CIKLET**

1. Dokumentacioni që IAL depoziton për hapjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet përbëhet nga:

a) Kërkesa e hapjes së programit/eve të reja të studimeve, në të cilën specifikohen njësisia bazë që do ta ofrojë atë, emërtimi, cikli, lloji dhe kodi i programit të studimit, kreditet që fitohen, kohëzgjatja normale, forma dhe gjuha e studimit, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

b) Të dhënat për aktin e hapjes dhe të lejes për fillimin e veprimtarisë akademike të institucionit dhe aktin e hapjes/riorganizimit të njësisë kryesore që e ofron, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

c) Propozimi i njësisë bazë, shoqëruar me argumentet përkatëse që mbështesin nevojën për hapjen e programit/programeve të ri/reja.

d) Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).

e) Mandatpagesën për vlerësimin nga eksperti të programit sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 10.5.2017, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.2.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të Këshillit të Ministrave.

f) Lista e plotë emërore e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, për të gjitha programet e studimit, së bashku me ngarkesat dhe formën e punësimit, si dhe titullin dhe gradën përkatëse. Dosja e personelit përmban:



i) jetëshkrimin;

ii) kontratën e punës për personelin efektiv ose një aktmarrëveshje dypalëshe për personelin e planifikuar për t'u angazhuar me kohë të plotë në rast të hapjes së programit;

iii) dokumente që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat (fotokopje);

iv) letrën e angazhimit të çdo anëtarit të personelit akademik të planifikuar për t'u angazhuar me kohë të pjesshme dhe lejen e punëdhënësit kryesor (sipas nenit 64, pika 2 e ligjit nr. 80/2015).

v) Në rastin e hapjes së një programi studimi në gjuhë të huaj, personeli akademik i rekrutuar duhet të plotësojë së paku një nga kriteret e mëposhtme:

- Të ketë fituar së paku një diplomë të një programi studimi në një nga ciklet e studimeve universitare të kryer në gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit.

- Të zotërojë nivelin C1 të njohjes së gjuhës respektive, në të cilën do të ofrohet programi, e vërtetuar përmes testeve ndërkombëtare, të cilat ndodhen në listën e miratuar nga MASR-ja për pranimet në ciklin e dytë dhe të tretë.

vi) Deklaratë mbi numrin e përgjithshëm të studentëve ekzistues dhe të kuotave të studentëve të parashikuara për programin/et të reja që kërkohen të hapen. Kjo deklaratë të shoqërohet me deklaratën nga subjekti (*të nënshkruar nga titullari dhe me vulën e institucionit*) mbi përmbushjen e standardeve akademike dhe të infrastrukturës dhe mbi sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për përfundimin e studimeve nga secili student i regjistruar, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

g) Modeli i kontratës së shërbimit (regjistrimit) që studenti lidh me IAL-në, si dhe tarifa e shkollimit për studentët, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

h) Në rast se IAL-ja parashikon zgjerim të infrastrukturës ekzistuese në dispozicion të programeve, të depozitohet:

i) relacioni i verifikimit të godinës së re, i përpiluar nga një person juridik apo fizik i licencuar nga organi kompetent shtetëror, sipas kuadrin ligjor në fuqi (*shoqëruar me kopjen e njësuar me origjinalin të licencës së këtij të fundit*).

ii) Planimetria dhe planvendosja e godinës/pjesës së re të institucionit, leja e shfrytëzimit të godinës, së bashku me bazën

materiale dhe didaktike. Aktin e posedimit të godinës apo kontratën e qirasë me afat së paku 3-vjeçar, të shoqëruar me vërtetimin e pronësisë të qiradhënësit.

i) Dokumentacion mbi programet e studimit, të plotësuar në të gjitha elementet e tij, në zbatim të VKM-së për elementet e programeve të studimit:

i) Rregullorja e IAL-së;

ii) Rregullore mësimore e programit të studimit;

iii) Plani mësimor për çdo program studimi;

iv) Programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkuara nga hartuesit/titullarët e tyre. Në rastin kur IAL-ja aplikon për hapjen e më shumë se një programi studimi në të njëjtën kohë, syllabuset e lëndëve që mund të shfaqen në më shumë se një program studimi depozitohen në një kopje të vetme.

j) Gjithë dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu duhet të depozitohet edhe i skanuar në format elektronik (PDF) në një CD/*flash drive*, të cilat paraqiten së bashku me dokumentacionin për aplikim.

k) Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendës ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi edhe i:

i) Aktit të themelimit/licencimit të institucionit në vendin e origjinës.

ii) Aktit të akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.

iii) Dokumentit zyrtar bashkëpunimi (*marrëveshje kuadër*), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit.

iv) Marrëveshjes specifike për programin konkret të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik etj. Kjo marrëveshje mund të jetë dhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore.

v) Llojit të diplomës (*e dyfishtë, e shumëfishtë, e përbashkët*) dhe modelin e diplomës të miratuar nga të dyja palët.

vi) Deklaratë për plotësimin e standardeve akademike edhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi (deklarata e nënshkruar nga titullari dhe me vulë të institucionit), sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.



l) Në rast deklarimi të rremë, subjekti juridik i nënshtrohet përgjegjësisë penale të parashikuar në Kodin Penal. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, MASR-ja nis procedurën e kontrollit dhe më pas, në rast të vërtetimit të dyshimeve, ia përcjell të dhënat organit kompetent.

2. Procedura për shqyrtimin e aplikimeve për hapjen e programeve të reja të studimit të të gjitha cikleve.

a) Kërkesa dhe dokumentacioni, i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, depozitohen në MASR. Struktura e ngarkuar së bashku me strukturat juridike, brenda tri javëve, bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së që të bëjë plotësimin /saktësimin e dokumentacionit, brenda katër javëve nga data e kthimit për plotësim /saktësim. Në mungesë të plotësimit/saktësimit të dokumentacionit të kërkuar, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet, duke konsideruar që subjekti ka hequr dorë në heshtje nga kërkesa e bërë.

b) Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu i kalon për vlerësim ekspertit, të caktuar nga MASR-ja, i zgjedhur nga lista e ekspertëve të miratuar.

Eksperti brenda tre javësh dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i kërkohet plotësimi i tij, brenda tri javësh nga marrja e njoftimit nëpërmjet ministrisë.

c) Dokumentacioni i plotësuar i kalon për rivlerësim ekspertit, i cili, brenda tri javësh, dorëzon raportin e rivlerësimit në MASR. Praktika nuk mund të shqyrtohet më shumë se dy herë. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

d) Në rast kur vlerësimi përfundimtar i MASR-së është pozitiv, ministri miraton hapjen e programit të ri të studimit.

e) Në rast ankese nga ana e subjektit, ministri i MASR-së i kërkon mendim të argumentuar me shkrim Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Në përfundim është ministri i MASR, që vendos mbi refuzimin apo vijimësinë e praktikës së

depozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.

KREU III

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË TË GJITHA CIKLEVE

1. Dokumentacioni që IAL-ja depoziton për riorganizim të programeve të studimit përbëhet nga:

a) Kërkesa e institucionit për riorganizim programesh studimi, lloji, forma dhe gjuha e studimit, shoqëruar me të dhënat për aktin e hapjes/riorganizimit të programeve të studimit ekzistuese që kërkohen të riorganizohen. Në kërkesë argumentohen arsyet që mbështesin kërkesën për riorganizimin e programit.

b) Vendimi i Senatit dhe i Bordit të Administrimit të IAL-së.

c) Planet mësimore të programeve të propozuara.

d) Rregulloren e ciklit të studimeve të programeve që riorganizohen.

e) Programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullari i lëndës.

f) Lista e stafit akademik në funksion të programeve të studimit dhe forma e angazhimit (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme).

2. Procedura e shqyrtimit të riorganizimit të programeve të studimit.

a) Kërkesa dhe dokumentacioni depozitohen në MASR. Shqyrtimi mbi plotësimin dhe rregullsinë e praktikës së depozituar me dokumentet e kërkuara sipas këtij udhëzimi bëhet nga njësia përgjegjëse dhe struktura juridike në MASR, brenda tri javëve nga depozitimi i kërkesës. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit brenda katër javëve nga data e kthimit për plotësim/saktësim. Në mungesë të plotësimit/saktësimit të dokumentacionit të kërkuar, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

b) Dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertit. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi nga eksperti, subjektit i



kërkohet plotësimi i tij, brenda tri javësh nga marrja e njoftimit.

c) Dokumentacioni i plotësuar nga subjekti i kalon për rivlerësim ekspertit. Eksperti brenda tri javësh dorëzon raportin e rivlerësimit në MASR. Praktika nuk mund të shqyrtohet më shumë se dy herë. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika përkatëse refuzohet dhe arkivohet.

d) Në rast kur vlerësimi përfundimtar i MASR-së është pozitiv, ministri miraton programin e riorganizuar të studimit.

e) Në rast ankese nga ana e subjektit, ministri i kërkon mendim të argumentuar me shkrim Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Në përfundim është ministri i MASR-së, që vendos mbi refuzimin apo vijimësinë e praktikës së depozituar. Në rast refuzimi, praktika arkivohet në MASR.

f) Në rastin kur riorganizimi i programit bëhet për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, përshtatja e programeve të studimit me ndryshimet ligjore bëhet me vendim të Senatit Akademik të institucionit. MASR-ja, pasi njoftohet me shkrim nga institucioni i arsimit të lartë për ndryshimet e bëra në programet e studimit, në përputhje me kërkesat e reja të legjislacionit, merr masat për riregjistrimin e formave të reja të diplomave (nëse është e nevojshme).

KREU IV

PROCEDURAT PËR MBYLLJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË TË GJITHA CIKLEVE

1. Akti për hapjen e një programi studimi anulohet në rastet si më poshtë:

a) Institucioni i arsimit të lartë për arsye të ndryshme i drejtohet ministrit të MASR-së me kërkesën për mbylljen e një ose disa programeve të studimit të ofruar nga ky institucion. Kërkesa duhet të shoqërohet me vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. Institucioni është përgjegjës për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekje të programit.

b) Në rast se institucioni i arsimit të lartë nuk e aktivizon programin brenda dy viteve

akademike të njëpasnjëshme nga dalja e urdhrin të hapjes, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.

c) Në rastin kur programi i aktivizuar i studimit bëhet joaktiv për dy vite akademike të njëpasnjëshme, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme.

d) Programi i studimit i bërë i pavlefshëm, mund të rihapet pasi IAL-ja depoziton në MASR projektin për rihapjen e tij, si kërkesë për program të ri.

e) Bazuar në konstatime të vërtetuara mbi mosrespektimin, nga ana e një institucioni të arsimit të lartë, të kriterëve të ligjshmërisë dhe/ose të akreditimit të një programi studimi.

2. Bazuar në rastet e përcaktuara në germën “a” të pikës 3 të këtij kreu, ministri i MASR-së urdhëron mbylljen e programit përkatës, në fund të vitit akademik.

3. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

KREU V

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT, “SPECIALIZIME AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË”

1. Kriteret të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”

a) Këto programe organizohen dhe realizohen nga IAL-të të cilat janë të integruara me strukturat shëndetësore universitare ose nga IAL-të që kanë marrëveshje bashkëpunimi me strukturat shëndetësore universitare.

b) Strukturat shëndetësore universitare dhe të rrjetit formues duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore, si dhe standardet specifike të programeve të studimit, në të dyja rastet e përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike.

c) IAL-të, publike dhe jopublike, vendëse ose të huaja, që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit pranë ministrisë, duhet të kenë zhvilluar dhe akredituar /riakredituar programe të studimit të



integruara të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë, të paktën me kohëzgjatje 5-vjeçare (300 ECTS) në programet Stomatologji dhe Farmaci, dhe të paktën 6-vjeçare (360 ECTS), në programin Mjekësi e Përgjithshme.

d) Hapja e programeve të studimit bëhet kur plotësohen kriteret infrastrukturore, organizative, si dhe kriteret e lidhura me personelin akademik e ndihmës që do të përfshihen në realizimin e disiplineve apo veprimtarive të tjera formuese, duke marrë në konsideratë dhe objektivat e nevojat për zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë.

e) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreu II të këtij udhëzimi dhe kriterëve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të studimit. Strukturat shëndetësore universitare që janë pjesë integrale e tyre duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për strukturat shëndetësore universitare, si dhe standardet specifike të programeve të studimit. Të njëjtat kriteret dhe standarde specifike duhet të plotësojnë edhe strukturat shëndetësore universitare me të cilat IAL-ja që paraqet kërkesën për hapjen e programeve të studimit, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e programit të studimit.

f) IAL-të që paraqesin kërkesën për hapjen e programeve të studimit, duhet të dokumentojnë/verifikojnë paraprakisht që struktura spitalore dhe rrjeti formues që do të angazhohet në secilin program studimi, plotëson kriteret dhe standardet specifike të programeve të studimit.

g) Programet e studimit mund të organizohen dhe zhvillohen bashkërisht nga IAL-të të cilat kanë domosdoshmërisht njësi baze dhe njësi kryesore në fushën e mjekësisë, mbi bazën e marrëveshjeve ndër-institucionale përkatëse, si dhe marrëveshjeve specifike për organizimin e këtyre programeve. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor. IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të

nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

h) Për realizimin e programeve të studimit, IAL-të mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me struktura shëndetësore universitare të huaja, të licencuara për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës. Në këtë rast, kërkesa e IAL-së për hapjen e programeve të studimit shoqërohet edhe me statusin ligjor dhe dokumentacionin ligjor të strukturës shëndetësore universitare të huaj për zhvillimin e aktivitetit shëndetësor në vendin e origjinës, si dhe konfirmimin e këtij statusi nga ministri i MASR-së dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë në Republikën e Shqipërisë.

i) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me IAL të huaja zbatohen standardet shtetërore të cilësisë të vendit, ku zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë mësimore të programit.

j) Nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore, edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

k) Rrjeti formues është përcaktuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në bazë të marrëveshjeve dhe protokolleve të nxitura nga IAL-të interesuara.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”

a) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga pedagogë të angazhuar me punë klinike/diagnostike dhe me tituj akademikë, si: *profesor, profesor i asociuar* ose gradë shkencore *doktor/PhD*.

b) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga:

i) Personel akademik me kohë të plotë me tituj akademikë dhe grada shkencore, jo më pak se 50% të pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Të paktën 1 (një) pedagog me kohë të plotë, me titullin akademik “Profesor”, duhet t’i përkasë fushës së programit të studimit.

ii) Personeli akademik me kohë të integruar, në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve



që mbulojnë programin e studimit, të cilët ushtrojnë profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Ky personel akademik të ketë eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore të rrjetit formues kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore.

iii) Personel akademik me kohë të pjesëshme, për disiplina të veçanta, jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, me të cilët lidhet një kontratë sipas nevojave të strukturës së programit të studimit.

c) IAL-të dhe strukturat shëndetësore të rrjetit formues të tyre, sipas kompetencave respektive, përcaktojnë mënyrën e përfshirjes së personelit të strukturave shëndetësore universitare, në zbatimin e programit të studimit.

d) Përgjegjësi/Drejtuuesi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. Përgjegjësi/Drejtuuesi i programit të specializimit është njëkohësisht edhe kryetari i Këshillit Drejtues të programeve të studimeve specializuese afatgjata, zgjidhet nga anëtarët e këtij këshilli me shumicë të thjeshtë votash (50% + 1). Përgjegjësi i një programi studimi në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një tjetër programi studimi që realizohet nga IAL-të.

e) Këshilli drejtues i programit të studimit të specializimeve afatgjata punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit përkatës. Këshilli Drejtues i programit përkatës të studimeve specializuese afatgjata ngrihet në nivel njësie kryesore dhe përbëhet nga të paktën 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë të IAL-së, jo më pak se 2 (dy) pedagogë për çdo program studimi që ofron njësi kryesore, të cilët duhet të jenë figura të spikatura në fushën e specialitetit përkatës, me përvojë klinike dhe akademike të paktën 10-vjeçare.

f) Drejtimi i specialistit i ngarkohet, në cilësinë e udhëheqësit, një pedagogu (udhëheqës akademik) dhe/ose një anëtar i personelit të strukturës shëndetësore të rrjetit formues (udhëheqës klinik/tutori) të

programit të studimit i cili/të cilët udhëheqin specialistin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit.

g) Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specialisti. Udhëheqësi klinik/tutori ka një eksperiencë profesionale të paktën 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencore “Doktor”. Numri maksimal i studentëve specialistë që mund të ndiqet nga udhëheqësi akademik /klinik është 3 (tre).

h) Udhëheqësi klinik/tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe ka kontratë bashkëpunimi me IAL-në që ofron programin specializues. Kur tutori nuk është pjesë e personelit me kohë të plotë të strukturës që ofron programin e specializimit, specialistit i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit. Për caktimin e udhëheqësit klinik merret mendimi i drejtuesit të strukturës shëndetësore dhe udhëheqja e tij klinike konsiderohet si pjesë e orarit të punës.

i) Aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin asistencial/profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës në selinë ku realizohet programi i studimit nga personeli i strukturave shëndetësore universitare kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të këtij shërbimi.

j) Specialisti i përfshirë në rrjetin formues merr gradualisht përgjegjësi klinike gjatë specializimit.

k) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në programet e studimit propozohen nga njësi/njësitë bazë propozuese të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Ato bëhen publike pas miratimit nga organet drejtuese të IAL-së dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

l) IAL-të duhet të përcaktojnë modalitetet e koordinimit dhe gjenerimit të kuotave për specializimet afatgjata në fushën e mjekësisë, me kërkesat të sistemit shëndetësor kombëtar



nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë.

m) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”.

a) Programet e studimit të ciklit të tretë, “Specializime afatgjata në fushën e mjekësisë”, përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese dhe 20% të ECTS-ve totale për studime të organizuara teorike, të shpërndara në vite, sipas një plani të studimit.

b) Raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e studimit përbëhet nga:

i) 60% lëndë specifike;

ii) 30% lëndë karakterizuese të fushës;

ii) 5% lëndë të formimit bazë, ndërdisiplinore ose integruese dhe për aktivitete të tjera;

iii) 5% provimi përfundimtar etj.

15% e totalit të lëndëve specifike dhe 15% e totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje.

c) Njësia bazë propozuese harton Rregulloren e programeve të studimeve specializuese afatgjata, me anekset specifike për çdo program, në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementet përbërëse të nevojshme për realizimin e programit, dhe ia paraqet Senatit Akademik të IAL-së për miratim. Në rregullore duhet të përcaktohet edhe:

i) vlerësimi i njohurive teorike dhe praktike të specializantit, në fund të çdo viti akademik;

ii) modalitetet e vlerësimit përfundimtar të specializantit, i cili i nënshtrohet provimit përfundimtar përkatësisht për njohuritë teorike, praktike ose paraqitjes së temës eksperimentale-studimore të diplomës.

d) Nevoja për formim të specializuar në kuadër të programit të studimit dhe madhësia e rrjetit formues përcaktohet mbi bazën e kapacitetit formues të strukturës shëndetësore universitare edhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.

e) Për realizimin e programit të studimit, IAL-të garantojnë personelin akademik të

nevojshëm me tituj dhe grada shkencore.

f) Në kuadër të programit të studimit, specializantët caktohen pranë njësive /shërbimeve/reparteve të strukturave shëndetësore universitare, pjesë e rrjetit formues, në përputhje me planin e studimit të miratuar dhe për kohën e nevojshme për të fituar aftësitë profesionale.

KREU VI

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË”

1. Kritere të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë”

a) Programet e studimit “Doktoratë” mund të hapen dhe të ofrohen nga IAL-të publike dhe jopublike që kanë statusin Universitet ose Akademi, vendëse ose të huaja, të cilat kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit “Doktoratë”.

b) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreut II të këtij udhëzimi dhe kritereve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë”.

c) Programet e studimit të doktoratës realizojnë formimin bazuar mbi hartimin e projekteve individuale për aftësimin e pavarur të kërkimit shkencor, duke u dhënë doktorantëve një kulturë ndërdisiplinore në kuadër të një projekti shkencor inovativ, që ka për qëllim përgatitjen e tyre shkencore dhe profesionale. IAL-ja depoziton së bashku me dokumentacionin për hapjen e programeve të studimit edhe projektet kërkimore–shkencore të hartuara për programin e studimit.

d) IAL-të nxisin nivelin e zhvillimit të kërkimit shkencor dhe ndihmojnë në aftësimin e studentit për të përfunduar me sukses programin e studimit.

e) IAL-të, në kuadër të programit të studimit organizojnë aktivitete me impakt në formimin e përgjithshëm, si dhe këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore, seminare dhe debate ndërdisiplinore, të lidhura ngushtë me fushën



specifike në të cilën ndjekin studimet dhe që i ndihmojnë në punën e tyre kërkimore, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme të IAL-ve.

f) IAL-të ndihmojnë në aftësimin e studentit për përvetësimin e metodologjive të kërkimit për veprimtari krijuese të pavarura, si: artikuj shkencorë, prezantime, qasje standarde për referenca, bibliografi, indekse dhe të shkruarit e përmbajtjes, si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës, punën e pavarur, përdorimin e burime të informacionit, administrimin dhe përpunimin e informacionit, përdorimin e teknologjive bashkëkohore për studime e komunikime, përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave, njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën kërkimore të doktorantit, si edhe përvetësimin e aftësive komunikuese me nivel shkencor.

g) Për realizimin e projektit kërkimor, IAL-të garantojnë personelin e tyre akademik të nevojshëm me tituj dhe grada shkencore.

h) IAL-ja ofruese e programit të studimit duhet të ketë struktura administrative dhe kërkimore të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara për kryerjen e kërkimeve dhe mund të bashkëpunojë me një apo më shumë IAL, vendëse apo të huaja, në bazë të marrëveshjeve të lidhura midis tyre, në mbështetje të procesit dhe përmirësimit të standardeve.

i) Programet e studimit kanë një kohëzgjatje jo më pak se 3 vite akademike dhe jo më shumë se 5 vite akademike dhe zhvillohen me kohë të plotë. Shtyrja e kohëzgjatjes bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statutet e institucionit. Në rastet kur doktoranti është i punësuar si personel akademik, kërkimor, shkencor në një institucion tjetër të arsimit të lartë, të kërkimit bazë ose të zbatuar, programi i studimit mund të zhvillohet me kohë të zgjatur. Në këtë rast, IAL-të përcaktojnë vetë tarifën shtesë të studimit.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

a) Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga pedagogë me tituj akademikë të kategorisë “Profesor”.

b) Në rastet kur programet e studimit do të kryhen bashkërisht me një IAL të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, udhëheqësi i IAL-së së huaj mund të jetë edhe me gradën shkencore “Doktor”/PhD.

c) Drejtuesi shkencor i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e ecurisë të studentit, si dhe përparimin e punës kërkimore të zhvilluar.

d) Njësia bazë ngarkon një prej anëtarëve të personelit akademik të programit të studimit që mban të paktën titullin akademik të kategorisë “Profesor”, në cilësinë e përgjegjës të programit të studimit.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

a) Përgjegjësi i programit të studimit ndjek të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe zbatimin e programit të kërkimeve, duke siguruar praninë dhe angazhimin e personelit akademik të kualifikuar në fushën shkencore të këtij programi.

b) Njësia bazë propozuese harton rregulloren e programit të studimit në të cilën parashikohen të gjitha proceset dhe elementët përbërës të nevojshëm për realizimin e këtij programi. Rregullorja miratohet nga Senati Akademik.

c) Në përfundim të çdo viti akademik, drejtuesi shkencor miraton raportin e aktiviteteve të kryera nga doktorantët në përputhje me rregulloren e ciklit të programit të studimit.

d) Programet e studimit mund të hapen dhe zhvillohen bashkërisht midis IAL-ve mbi bazën e marrëveshjeve ndër-institucionale përkatëse. Në këtë rast, selia administrative dhe institucioni përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor.

e) IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.



f) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

g) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit në programet e studimit propozohen nga njësia/njësitet bazë propozuese e/të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen nga organet drejtuese të IAL-së. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

h) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

KREU V

KRITERET E POSAÇME PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT, “MASTER EKZEKUTIV”

1. Kriteria të përgjithshme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “master ekzekutiv”.

a) IAL-të që paraqesin dokumentacionin sipas kreut II të këtij udhëzimi dhe kriterëve të posaçme të këtij kreu, për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit, “master ekzekutiv”.

b) Programet e studimit “master ekzekutiv” mund të hapen dhe të ofrohen nga IAL-të publike dhe jopublike që kanë statusin Universitet ose Akademi, vendëse ose të huaja, të cilat kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit “master ekzekutiv”. Gjithashtu, kërkesa mund të paraqitet edhe nga IAL-të të cilat nuk kanë programe studimi të licencuara dhe akredituara/riakredituara të ciklit të parë dhe të dytë në të njëjtën fushë ose fushë të përafërt me atë të programit “master ekzekutiv”, por që plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- kanë akreditim institucional;
- kanë përvojë në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të tretë;

- dëshmojnë se kanë personelin akademik për të plotësuar, menjëherë pas licencimit të programit, strukturën e departamentit që ofron programin e studimit.

c) Programet e studimit mund të hapen dhe zhvillohen bashkërisht midis IAL-ve mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale përkatëse. Në këtë rast, institucion përgjegjës për realizimin dhe mbarëvajtjen e tyre është IAL-ja pranë të cilit zhvillohet pjesa më e madhe e veprimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i procesit mësimor.

d) IAL-ja përgjegjëse për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit duhet të disponojë burimet financiare, infrastrukturën dhe personelin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

e) Për realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.

2. Personeli akademik i programit të studimit të ciklit të tretë, “master ekzekutiv”

a) Personeli akademik i programit të studimit përbëhet nga personeli akademik i kategorisë “Profesor” i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme në IAL. Në personelin akademik të programit të studimit mund të përfshihet edhe personeli akademik i IAL-ve partnere në hapjen e programeve të studimit mbi bazën e marrëveshjeve ndërinstitucionale.

b) Në varësi të shkallës së specializimit të programit të studimit, mund të jenë pjesë e personelit të programit edhe specialistë të fushës me përvojë profesionale në fushën e programit, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i lartë se 30% e personelit akademik.

3. Organizimi i programit të studimit të ciklit të tretë, “master ekzekutiv”

a) Programet e studimit hapen në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë për programet e studimit të ciklit të tretë, me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike (respektivisht me 60 ose 120 kredite ECTS).

b) Struktura e programit të studimit pasqyrohet e plotë në planin mësimor ndërsa modalitetet e realizimit të programit të studimit dhe të veprimtarive të tij pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.



c) Veprimtaritë mësimore mund të zhvillohen në formën e leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave mësimore, vizitave mësimore, konferencave, mësimit ndëraktiv, stazheve.

d) Praktikrat mësimore dhe stazhet mund të zhvillohen pranë institucionit të arsimit të lartë ose pranë institucioneve të tjera bashkëpunuese, në varësi të objektivave formuese dhe të strukturave që disponon vetë IAL-ja.

e) Veprimtaritë mësimore, për programet e studimit me kohëzgjatje 1 vit akademik, nuk duhet të përmbajnë më pak se 360 orë në auditor.

f) Veprimtaritë mësimore, për programet e studimit me kohëzgjatje 2 vite akademike, nuk duhet të përmbajnë më pak se 720 orë në auditor.

g) Programet e studimit përmbillen me tezë diplome.

h) Njërit prej anëtarëve të personelit akademik të programit të studimit që mban të paktën titullin “profesor i asociuar” i ngarkohet, në cilësinë e përgjegjës, drejtimi i programit të studimit. Përgjegjësi i një programi studimi në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një programi tjetër studimi që realizohet nga IAL-ja. Për planifikimin dhe zbatimin e planit të studimit, përgjegjësi i programit të studimit bashkëpunon me personelin akademik të këtij programi.

i) Kriteret, kuotat, tarifat dhe modalitetet e pranimit dhe transferimit në programet e studimit përcaktohen nga njësia/të bazë propozuese të programit të studimit, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe miratohen nga organet drejtuese të IAL-së. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR-së.

j) Gjatë periudhës së studimeve në një program studimi, studenti nuk mund të ndjekë njëkohësisht programe të tjera studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

KREU VIII KONTROLLET DHE MASAT

1. Programet e studimit të ofruar nga IAL-të i nënshtrohen kontrolleve të zbatimit të ligjshmërisë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të paktën një herë në 3 vjet. Nëse gjatë kontrolleve evidentohen shkelje të dispozitave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në

Republikën e Shqipërisë” apo të akteve nënligjore, grupi i kontrollit i ngritur me urdhër të ministrit të MASR-së përgatit një raport për ministrin mbi shkeljet e evidentuara. Raporti i grupit të kontrollit i dërgohet edhe IAL-së përkatëse.

2. Pas njoftimit mbi shkeljet dhe detyrimet mbi zbatimin e normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, institucioni dërgon komentet dhe sqarimet e tij (nëse ka) në lidhje me raportin e hartuar nga grupi i kontrollit. Grupi i kontrollit pasqyron në raportin përfundimtar saktësimet që i gjykon të arsyeshme dhe jep qëndrimin përkatës për pjesën e refuzuar të vërejtjeve të institucionit të arsimit të lartë.

3. Pas marrjes së raportit përfundimtar, institucioni dërgon një deklaratë të firmosur (deklaratë angazhimi), në të cilën angazhohet se do të plotësojë brenda afatit të përcaktuar nga MASR-ja kriteret e paplotësuara sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi.

4. Në rast se institucioni nuk arrin të zbatojë angazhimet brenda afatit të përcaktuar, ministri i MASR-së pezullon programin përkatës të studimit deri në përmbushje të detyrimeve ose mbyllje të programit të studimit.

5. Mbyllja e programeve të studimit bëhet me urdhër të ministrit të MASR-së, në fund të vitit akademik. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

KREU IX DISPOZITA TRANZITORE TË FUNDIT

1. Në zbatim të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përjashtimisht aplikimet për hapje /riorganizim të programeve të reja/ekzistuese të studimit do të pranohen gjatë vitit akademik 2017-2018 për vitin 2018-2019 dhe në vijim deri në muajin korrik të vitit 2018.

2. Aplikimet në vitet në vijim për hapje/riorganizim të programeve të reja /ekzistuese të studimit bëhen brenda datës 30



nëntor të vitit korrent për vitin e ardhshëm akademik.

3. Udhëzimi nr. 11, datë 28.2.2011, “Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës”, shfuqizohet në pjesët që rregullon programet e studimit.

Shtojca 1

KËRKESË PËR HAPJEN DHE/OSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Institucioni i arsimit të lartë: _____

Viti akademik: _____

Data e kërkesës: ____/____/____

I. INFORMACION MBI INSTITUCIONIN

Të dhënat për aktet themelore	Lloji i aktit (VKM/urdhër)	Nr.	Datë
Licencimi i institucionit			
Leja për fillimin e veprimtarisë			
Akreditimi i institucionit			
Hapja/riorganizimi i njësisë kryesore ku ofrohet programi			
<i>Në rastin e aplikimeve për hapjen e programeve të ciklit të tretë</i>			
Hapja e programeve të ciklit të parë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt			
Akreditimi i programeve të ciklit të parë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt			
Hapja e programeve të ciklit të dytë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt			
Akreditimi i programeve të ciklit të dytë në të njëjtën fushë/fushë të përafërt			

II. INFORMACION MBI PROGRAMIN E STUDIMIT

1. Të dhëna të përgjithshme:

Emërtimi i programit të studimit:	
Cikli i studimeve:	
Lloji i programit:	
Kodi i programit:	
Totali i krediteve (ECTS):	
Kohëzgjatja normale në vite	
Forma e studimit:	
Gjuha e studimit:	
Vendimi i njësisë bazë dhe kryesore për hapjen e programit të studimit	



(Numri i vendimit dhe data)	
Vendimi i Senatit Akademik për hapjen e programit të studimit (Numri i vendimit dhe data)	

Shënim: Në rastin kur programi i studimit është i përbashkët, të përfshihen të gjitha vendimet e marra, sipas modelit më sipër.

2. Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit

a) Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit mësimor.

--

b) Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor

--

c) Mundësitë për punësim

--

3. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	
Institucione të huaja të arsimit të lartë	
Subjekte të tjera publike apo private	

Shënim: Në rastin e bashkëpunimit me një apo disa struktura të tjera, të bashkëlidhen marrëveshjet përkatëse.

4. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit

Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit hartohet bazuar në standardet shtetërore dhe kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.



5. Personeli akademik për realizimin e programit

Personeli akademik (emri, mbiemri)	Titulli/grada shkencore	Institucioni	Njësia kryesore	Njësia bazë	Lloji i angazhimit (me kohë të plotë/të pjesishme)

6. Plani mësimor me përbërësit specifike sipas kuadrit ligjor në fuqi.

7. Infrastruktura në dispozicion të programit (Informacion lidhur me: auditorët, laboratorët e duhur, bibliotekën, mjetet kompjuterike sistemet IT etj.

8. Kriteret e pranimit të studentëve në program.

Numri i propozuar i studentëve që do të pranohen në program	
Numri minimal i studentëve për hapjen e programit	

9. Tarifa e shkollimit

Tarifa e shkollimit		Kostoja e shkollimit	
---------------------	--	----------------------	--

10. Financimi i programit

Burimi i financimit të programit. Financime të tjera që mund të mbulojnë pjesërisht apo plotësisht koston e shkollimit, nëse ka të tilla.

III. DEKLARATA PËR PLOTËSIMIN E STANDARDEVE AKADEMIKE DHE STANDARDEVE SHTETËRORE SIPAS AKTEVE LIGJORE E NËNLIGJORE NË FUQI

--



IV. AUTODEKLARIM

Ne/Unë i/e nënshkruari/a _____

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Të gjithë të dhënat janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë penale në rast dhënie informacioni të pavërtetë, si dhe pranoj t'i nënshtrohem verifikimit nga organet përkatëse për të gjithë informacionin e paraqitur si më sipër.

2. IAL-ja është e regjistruar në QKB si person juridik, me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën përkatëse të arsimit, si më poshtë:

Subjekti juridik përgjegjës për IAL-në _____:

NUIS: _____:

3. Subjekti juridik disponon vërtetim pronësie nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nr.____, datë ____/____/____ ku do të zhvillohet veprimtaria, apo kontratë qiraje me kohëzgjatje jo më pak se tri vite akademike nga momenti i paraqitjes së kësaj kërkesë.

4. Deklaroj se subjekti juridik disponon mjedis të përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor, bazën materiale të nevojshme sipas standardeve shtetërore në fuqi.

5. Deklaroj se subjekti juridik ka krijuar kushteve për studentët me aftësi të kufizuara në mjediset ku ushtrohet veprimtaria e mësimdhënies.

6. Subjekti juridik dhe personat përgjegjës për administrimin e tij nuk janë në proces gjykimi, hetimi, si dhe nuk rezultojnë të dënuar në fushën që kërkohet të ushtrohet aktiviteti.

7. Deklaroj se subjekti juridik plotëson të gjitha standardet akademike dhe shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Deklaroj se subjekti juridik plotëson të gjitha standardet infrastrukturore shtetërore sipas kuadrit ligjor në fuqi.

9. Deklaroj se subjekti juridik nuk rezulton debitor ndaj organeve tatimore në nivel qendror dhe vendor për të gjitha llojet e detyrimeve, përfshirë energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë.

10. Deklaroj se subjekti juridik disponon lejen higjieno-sanitare për çdo mjedis ku do të zhvillohet veprimtaria dhe aktin për mbrojtjen kundër zjarrit, brenda afateve të vlefshmërisë.

11. Deklaroj se subjekti juridik disponon vlerat monetare për financimin e programit përkatës të studimit dhe është përgjegjës ndaj studentëve për mos respektimin e kontratave të lidhura.

REKTORI

Data _____ Firma, vula

ADMINISTRATORI I PERSONIT JURIDIK
PËRGJEGJËS PËR IAL-NË JOPUBLIKE

Data _____ Firma, vula

VENDIM

Nr. 88, datë 28.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.12.2017,
mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë
dokumentesh, çështjen me nr. 66, akti që i përket:

KËRKUES: Albert Muçohasanaj

SUBJEKTI I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me
Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2017-304, datë
7.4.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr.
73, datë 10.5.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr.
11, datë 9.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Elbasan.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 31, 32, 42,
131/1/£, 134/1/i dhe 142 të Kushtetutës së
Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së dhe
neni 4 i protokollit 7 të kësaj konvente; ligji nr.
8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe
funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës
së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Gani Dizdari,
mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
kërkuesit Albert Muçohasanaj, që kërkoi pranimin
e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të
interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi
pranimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi
çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Kërkuesi është dënuar me 29 vjet, 10 muaj e 14 ditë burgim nga gjykatat e shtetit italian për kryerjen e disa veprave penale. Pas ekstradimit në Shqipëri për vuajtjen e dënimit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kërkuar nga gjykata njohjen e vendimeve penale të gjykatave italiane.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 11, datë 9.3.2016, ka vendosur, midis të tjerave: “Njohjen e vendimeve penale të huaja dhe në bashkëm të dënimeve vuajtjen e dënimit me 25 vjet burgim nga i gjykuari Albert Muçobasanaj.”.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 73, datë 10.5.2016, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit.”.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-304, datë 7.4.2017, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit.”.

II

5. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt shqyrtimi me pretendimin se këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimit e mëposhtme:

5.1. *Gjykatat e faktit kanë vendosur në kundërshtim me ligjin* kur kanë njohur vendimet e gjykatave italiane, pasi sipas përllogaritjes së tyre rezulton se kërkuesi duhet të vuajë një kohë më të gjatë në burgim. Konkretisht, sipas kërkuesit, kanë mbetur 20 vjet nga dënimi i dhënë nga gjykatat italiane, ndërkohë që gjykatat shqiptare, në kundërshtim me ligjin, kanë vendosur se kërkuesit i kanë mbetur edhe 25 vjet burgim. Kjo përllogaritje cenon lirinë e personit, duke i dhënë në fakt një dënim më të gjatë se ai që kanë dhënë gjykatat me vendim të formës së prerë.

5.2. *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit*, pasi nuk ka marrë parasysh shtesën e rekursit që është paraqitur brenda afatit ligjor. Shtesa e rekursit, megjithëse është paraqitur brenda afatit, rezulton se nuk i është bashkëngjitur dosjes gjyqësore dhe kjo ka bërë që Kolegji Penal të mos e marrë atë në shqyrtim. Si pasojë, ai kolegji nuk është njohur me shkaqet thelbësore mbi të cilat mbështetej rekursi i paraqitur nga kërkuesi. Në këtë mënyrë është cenuar e drejta e aksesit në thelbin e saj.

6. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e bazuar dhe duhet të pranohet nga Gjykata vetëm për sa i takon pretendimit për mosmarrjen në shqyrtim të shtesës së rekursit, i cili, sipas subjektit të interesuar, rezulton se është paraqitur sipas rregullave procedurale. Ndërsa pretendimet e tjera, sipas tij, janë të pabazuara dhe nuk duhen marrë në shqyrtim nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika b, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi rezulton se ka parashtruar pretendime që hyjnë në juridiksionin e kësaj Gjykate.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatë të Lartë

8. Kërkuesi pretendon se në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, si dhe në shtesën e rekursit të depozituar më pas, ka paraqitur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor. Sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim as pretendimet e rekursit, as ato të parashtruara në shtesën e rekursit, i cili është paraqitur në kohë dhe sipas rregullave procedurale. Duke vepruar në këtë mënyrë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

9. Gjykata ka pranuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të çdo individi për një proces të rregullt ligjor. Në këtë vështrim, Gjykata mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që në parim u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6



i KEDNJ-së, gjë që përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e kësaj Gjykate nuk është zgjidhja e një çështjeje konkrete, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 84, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore, që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Sipas Gjykatës, në të tilla raste kërkuesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë e individit është garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, e drejta e individit për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 3.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë

është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 67, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substancial cenon të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 21, datë 24.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Rekursi është mjete procedural në dispozicion të kërkuesit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Po ashtu, jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 35, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin



ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 84, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime, që kanë të bëjnë me shkëljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 84, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga përmbajtja e dispozitave procedurale penale për rekursin rezultojnë se rekursi shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve (neni 433/2 i KPP-së). Ky kolegji verifikon legjitimitetin e kërkuarit, bazueshmërinë në ligj dhe në prova të rekursit, si dhe praninë e kriterëve ligjorë për shqyrtimin e saj. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim.

17. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezultojnë se kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Lartë edhe me një shtesë rekursi në datën 11.11.2016, e cila është regjistruar pranë Gjykatës së Apelit Durrës me nr. protokollin 4188/2, datë 17.11.2016. Sipas shkresës së kancelarit të Gjykatës së Lartë, nr. 2892/1, datë 12.7.2017, rezultojnë se administrata gjyqësore nuk ia ka bashkëlidhur akteve të çështjes penale nr. 1158/2016 shtesën e rekursit. Në këto kushte, rezultojnë se Kolegji Penal ka vendosur vetëm mbi bazën e rekursit dhe jo të shtesës së paraqitur për këtë qëllim.

18. Gjykata konstaton se referuar përmbajtjes së rekursit dhe shtesës së rekursit, pretendimet e parashtruara në të dyja këto akte janë të ngjashme dhe nuk rezultojnë të ketë diferenca thelbësore në shkaqe apo argumente lidhur me parregullsinë e procesit para gjykatave më të ulëta. Në të dyja parashtrimet, pra në rekurs dhe në shtesën e

rekursit, paraqitet si shkak kryesor argumenti se gjykatat shqiptare kanë llogaritur gabim vitet e burgimit që duhet të vuajë kërkuari, si rrjedhojë e vendimeve të gjykatave italiane. Konkretisht, referuar thelbit të pretendimeve të kërkuarit të parashtruara në shtesën e rekursit, ai pretendon se, ndryshe nga sa kanë vendosur gjykatat shqiptare, atij nuk i kanë mbetur 25 vjet, por 20 vjet burgim. Pra, sipas tij, vendimet e gjykatave shqiptare për konvertimin e dënimit nuk janë të bazuara në ligj dhe në këtë mënyrë ato janë të padrejta (fq. 2-3 e shtesës së rekursit). Të njëjtat pretendime i gjejmë edhe te përmbajtja e rekursit të paraqitur nga kërkuari, ku është theksuar se gjykatat kanë përlogaritur gabim dënimin e mbetur për t'u vuajtur nga kërkuari. Nisur nga ky fakt, Gjykata çmon se, megjithëse shtesa e rekursit nuk është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, kjo mangësi procedurale nuk ka rezultuar të ketë qenë e tillë që të ketë ndikuar në thelbin e vendimmarrjes së atij Kolegji.

19. Në vendimet e mëparshme të saj Gjykata ka pranuar se jo çdo shkëlje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkëljes së të drejtave kushtetuese. Ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkëlje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe do të ndikonte në rezultatin e vendimmarrjes (*shih vendimet nr. 25, datë 28.10.2005; nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se mosmarrja në shqyrtim e shtesës së rekursit nga Kolegji Penal nuk ka sjellë si pasojë cenimin substancial të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar.

21. Gjithashtu, përveç sa më lart, lidhur me pretendimet e tjera të kërkuarit se përlogaritja e viteve të mbetura nga dënimi penal i formës së prerë është bërë gabim apo se një apo disa nga veprat për të cilat ai ishte akuzuar dhe dënuar është amnistuar, Gjykata thekson se këto janë çështje të fazës së ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë ndaj të cilit kërkuari ka mjete ligjore ankimi, në përputhje me dispozitat e KPP-së, konkretisht të kreut II të tij, i cili i referohet shqyrtimit nga gjykata të çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve.

22. Nisur nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara dhe si të tilla ato nuk duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 89, datë 28.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.9.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 38, akti që u përket:

KËRKUESE: Shoqata e shoqërive që operojnë në fushën e lotove dhe basteve sportive

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Këshilli i Ministrave

Ministria e Financave

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 48, pika 2, shprehja “si dhe tarifën e mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit On-line, që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara” dhe i nenit 70, pika 12, shprehja “tarifa e mirëmbajtjes së tij që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara” të ligjit nr. 155,

datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën i fjalisë së fundit të pikës 1 të dispozitave të përgjithshme dhe i pikave 2 dhe 3 të kreut VI të VKM-së nr. 647, datë 14.9.2016, “Për përcaktimin e mënyrës dhe kriterëve të përzgjedhjes të operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit On-line (SQMO) si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”.

Shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën i pikës 1 të VKM-së nr. 331, datë 12.4.2017, “Për miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit On-line (SQMO), që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara” në lidhje me tarifën e mirëmbajtjes për kategorinë baste sportive.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 17, 18, 124, 131/1/a, 131/1/c, 134/1/h, 134/2 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Protokoll nr. 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 1); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarës, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në vitin 2008, Kuvendi i Shqipërisë (*Kuvendi*) ka miratuar ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”. Kurse në vitin 2015 ka miratuar ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 10033, datë 11.12.2008. Në nenin 1 të ligjit nr. 155/2015 përcaktohen kategoritë e lojërave të fatit të lejuara, kushtet, kriteret dhe procedurat që rregullojnë këtë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrat, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në



fushën e lojërave të fatit. Kurse sipas nenit 2 të ligjit, qëllimi i tij është të përcaktojë: “1. *Kuadrin e nevojshëm ligjor për mënyrën e organizimit, kushtet e funksionimit të lojërave të fatit dhe lejimin e shoqërive për të ushtruar këtë aktivitet. 2. Mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. 3. Mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së organizatorëve të lojërave të fatit. 4. Rregullat e përgjithshme për licencimin e lojërave të fatit, pezullimin dhe revokimin e licencës, si dhe autorizimin e veprimtarive të tjera të lidhura me industrinë e lojërave të fatit. 5. Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të lojërave të fatit. 6. Shpërndarjen e të ardhurave nga lojërat e fatit.”.*

2. Ky ligj ka parashikuar, gjithashtu, në nenin 48 të tij, se “1. *Sistemi Qendror i Monitorimit On-line (SQMO) i lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë shfrytëzohet nga AMLF-ja, e cila merr të dhënat nga sistemi në kohë reale. 2. Këshilli i Ministrave përcakton mënyrën dhe kriteret e përzgjedhjes së operatorit që do të ndërtojë SQMO-në, autoritetin përgjegjës që do të kryejë procedurat e përzgjedhjes, si dhe tarifën e mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit On-line që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara.”. Kurse sipas nenit 70, pika 12 të tij “*kushtet teknike të SQMO-së të lojërave të fatit, afatet maksimale të implementimit të projektit, tarifa e mirëmbajtjes së tij që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara, si dhe çdo çështje tjetër që ka lidhje me sistemin e monitorimit on-line miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.**

3. Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 647, datë 14.9.2016, “Për përcaktimin e mënyrës e të kriterëve të përzgjedhjes së operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit On-line (SQMO) dhe të autoritetit përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes” (VKM-ja nr. 647/2016). Sipas pikës 1 të dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi “*Operatori që ndërton Sistemin Qendror të Monitorimit On-line (SQMO) të lojërave të fatit kryen edhe procesin e shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes së tij, duke garantuar procesin e monitorimit on-line të të dhënave që do të përdoren nga AMLF-ja. Operatori merr vlerën e investimit nga tarifa që do të paguajnë shoqëritë e licencuara të lojërave të fatit për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit”.* Kurse sipas pikave 2 dhe 3 të kreut VI të tij, “2. *Tarifa që do të paguajnë shoqëritë e licencuara të lojërave të fatit përmban vlerën fikse për çdo pajisje/lojë fati për mirëmbajtjen e sistemit, si dhe vlerën në përqindje mbi të ardhurat bruto nga lojërat e fatit për shlyerjen e investimit dhe për ngritjen e*

përditësimin e sistemit SQMO. Formula, e cila do të shërbejë për llogaritjen e tarifës, do të jetë pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. 3. Tarifa që do të paguajnë shoqëritë e licencuara të lojërave të fatit, e propozuar nga subjekti i shpallur fitues, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

4. Në mbështetje të ligjit nr. 155/2017 dhe VKM-së nr. 647/2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 331, datë 12.4.2017 (VKM-ja nr. 331/2017), për miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së SQMO-së që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II

5. Kërkuesja, Shoqata e shoqërive që operojnë në fushën e lotove dhe basteve sportive, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se përmbajta e disa dispozitave të ligjit nr. 155/2015 dhe VKM-ve nr. 647/2016 dhe nr. 331/2017 janë të papajtuashme me Kushtetutën, për rrjedhojë ka kërkuar shfuqizimin e tyre. Në mënyrë të përmbledhur kërkuesja ka parashtruar këto argumente përpara Gjykatës:

5.1. Kërkuesja legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në kuptim në neneve 131/1/a dhe 134/1/h të Kushtetutës. Ajo është regjistruar si subjekt juridik, me 3 anëtarë themelues, me vendimin nr. 3784, datë 4.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas statutit të saj, qëllimi i krijimit të shoqatës është mbrojtja e interesave të shoqërive që operojnë në fushën e organizimit të lotove dhe basteve sportive, si dhe luajtja e një roli aktiv si përfaqësuese e interesave të anëtarëve të saj. Ajo provon edhe interesin e drejtpërdrejtë, pasi aktet e kundërshtuara që kanë parashikuar detyrimet financiare që shoqëritë e licencuara duhet të paguajnë zbatohen edhe ndaj anëtarëve të kësaj shoqate dhe ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e tyre. Po ashtu, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

5.2. Aktet ligjore të kundërshtuara shkelin lirinë e veprimtarisë ekonomike, të sanksionuar në nenin 11 të Kushtetutës dhe parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar në nenin 17 të Kushtetutës. Në rast se një pjesë e mirë e detyrës së AMLF-së



(Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit) do të kryhet nga një operator privat me anë të sistemit *on-line*, rrjedhimisht roli i AMLF-së ulet ndjeshëm dhe automatikisht edhe shpenzimet e saj do të ulen, pasi nuk do jetë më e njëjta ngarkesë pune. Nuk ka asnjë arsye pse shpenzimet e sistemit të mos paguhen nga fondi i të ardhurave që AMLF-ja disponon nga buxheti i saj. Sipas nenit 48 të ligjit nr. 155/2015, SQMO-ja do të shfrytëzohet nga AMLF-ja, pra ky sistem ngrihet në shërbim dhe funksion të saj.

5.3. VKM-të e kundërshtuara nuk sigurojnë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet masës së përdorur dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, për rrjedhojë mbi anëtarët e kërkueses aplikohen dy tarifa për të njëjtin shërbim. Kategoria e basteve është e vetmja kategori që paguan edhe tarifë ditore për çdo njësi, edhe tarifë në përqindje mbi xhiron vjetore që faturon. Njëkohësisht, kjo kategori paguan kundrejt AMLF-së edhe 3% të të ardhurave bruto nga loja, por jo më pak se 1,5 milionë lekë në vit. Në këto kushte, është totalisht e papërshtatshme që këtyre subjekteve t'u shtohet edhe pagesa për mirëmbajtjen e SQMO-së, kur ky shërbim përfshihet brenda aktivitetit monitorues të AMLF-së, për të cilin subjektet paguajnë sipas nenit 14 të ligjit. Edhe sipas pikës 1 të VKM-së nr. 647/2016, SQMO-ja është një sistem që i shërben tërësisht lehtësimit të punës së AMLF-së dhe jo subjekteve që duhet ta paguajnë.

5.4. Ky lloj shërbimi i është dhënë me koncesion një subjekti të vetëm, duke u cenuar liria ekonomike e anëtarëve të shoqatës, pasi nuk i lejon të zgjedhin midis disa operatorëve që kryejnë shërbimin.

5.5. Aktet e kundërshtuara bien ndesh me të drejtën e pronës private, sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i cili lejon kufizimin e kësaj të drejte nga shteti, por për interes publik. Në rastin konkret interesi është tërësisht i njëanshëm, pasi me anë të tarifës së mirëmbajtjes që do aplikohet, asnjë e ardhur nuk shkon në buxhetin e shtetit, por do shërbejë vetëm për përfitime të operatorit të përzgjedhur për ngritjen dhe mirëmbajtjen e SQMO-së, pra një operator privat.

5.6. Në rastin konkret nuk plotësohen kërkesat që imponon neni 17 i Kushtetutës për kufizimin e të drejtave. Nuk ekziston asnjë interes publik, pasi vjelja e tarifave nuk bëhet për llogari të shtetit, por

për llogari të një operatori privat të përzgjedhur për kryerjen e këtij shërbimi, i cili përfiton tarifa shumë herë më të larta sesa tarifat reale për shërbimin e ofruar, sipas VKM-së nr. 331/2017.

5.7. Tarifa që aplikohet nuk është proporcionale as me shërbimin e ofruar, madje është arbitrare dhe e bazuar në vlera alogjike, pasi në përcaktimin e saj nuk ka një kriter të bazuar që të përcaktojë vlerat e vërteta apo reale të kostove që duhen për mirëmbajtjen e një sistemi të tillë monitorimi *on-line*.

5.8. Përfitimet që operatori i merr vetëm nga kategoria e basteve, pra në shumën totale nuk janë të përfshira tarifat që përfiton operatori nga dy kategoritë e tjera (lotaria kombëtare dhe kazinotë elektronike).

5.9. Është cenuar parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, sepse aktet e kundërshtuara parashikojnë trajtim të diferencuar të subjekteve që preken prej tyre, kundrejt 2 kategorive të tjera që mbikëqyren nga AMLF-ja, konkretisht lotaria kombëtare dhe kazinotë elektronike, të cilat sipas VKM-së nr. 331/2017 nuk paguajnë përqindje mbi xhiron vjetore. Në rastin konkret ekzistonin mjete të tjera shumë herë më të përshtatshme për të arritur qëllimin dhe, konkretisht, kjo pagesë mund të kryhej nga subjekti që do ta shfrytëzojë dhe përdorë sistemin.

5.10. Shkaku i diskriminimit është mbi gjendjen ekonomike, pasi sikundër referon Këshilli i Ministrave, kategoria e basteve është kategoria më me pak numër njësisish dhe paguan në total më pak për tarifë ditore. Ligji i zbatueshëm nuk ka bërë një ndarje të kategorive me risk më të lartë monitorimi dhe me vështirësi më të lartë kontrolli nga AMLF-ja, pasi ato janë konsideruar të njëjta në këtë këndvështrim.

6. **Subjekti i interesuar Kuvendi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar këto argumente përpara Gjykatës:

6.1. Shoqatës, e cila përbëhet nga tri shoqëri që operojnë vetëm në fushën e basteve sportive, i mungon interesi i drejtpërdrejtë dhe i ligjshëm për të kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të shprehjes “si dhe tarifën e mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit On-line që dubet të paguajnë shoqëritë e licencuara”, të parashikuar nga neni 48, pika 2 dhe neni 70, pika 12 të ligjit nr. 115/2015.

6.2. Sistemi qendror i monitorimit *on-line* të lojërave të fatit është një sistem, i cili është i



vendosur në të gjitha vendet, për arsye se monitorimi *on-line* do të nxjerrë të dhëna shumë më të qarta dhe të sakta për xhiron, nivelin e taksave dhe fitimin e organizatorëve të lojërave të fatit.

6.3. Zbatimi i sistemit të monitorimit *on-line* është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me interesin publik, nga njëra anë, pasi ndikon në shmangien e informalitetit dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore, si dhe me zbatimin e parimit të barazisë dhe transparencës në sistemin e taksimit, dhe, nga ana tjetër, sepse subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e lojërave të fatit do të taksohen mbi bazën e të ardhurave bruto që realizohen nga ky sektor.

6.4. Rregullimi i ligjvënësimit është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar një veprim të tillë, pasi kjo ndërhyrje nuk cenon gjendjen financiare dhe veprimtarinë ekonomike që subjektet e licencuara për lojëra fati ushtrojnë. Nga ana tjetër, është vendosur një balancë e drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit për një ekonomi të formalizuar dhe kërkesës për mbrojtjen e lirisë së ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

6.5. Për sa i takon VKM-së nr. 331/2017, është një akt me karakter individual, për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues.

6.6. Lidhur me pretendimin për trajtimin e pabarabartë të kërkuar në raport me AMLF-në, pasi kjo e fundit është përjashtuar padrejtësisht nga pagesa e shpenzimeve për mirëmbajtjen e sistemit, në asnjë rast nuk mund të pretendohet që një autoritet publik, me kompetenca kontrolli dhe mbikëqyrjeje të një veprimtarie të caktuar shtetërore, të trajtohet në mënyrë të barabartë me subjektin privat që ushtron veprimtari me qëllim fitimi dhe që mbikëqyret nga autoriteti publik.

7. Subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar para Gjykatës:

7.1. Kërkuarja nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë, pasi nuk ka dorëzuar statutin e kësaj shoqate. Vendimmarrja për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë në këtë rast duhet të ishte e bordit drejtues të shoqatës dhe jo e kryetarit të bordit. Po ashtu, kërkuarja nuk legjitimohet *ratione personae* edhe për arsye se kryetarit të bordit A. Sh. dhe vetë bordit u ka mbaruar mandati, për rrjedhojë nuk kanë tagër për të vënë në lëvizje Gjykatën, me qëllim

shqyrtimin e kushtetutshmërisë së akteve objekt gjykimi.

7.2. Bazuar në përkufizimet ligjore dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, VKM-ja nr. 647/2016 është një akt individual, për rrjedhojë shqyrtimi i këtij vendimi është jashtë juridiksionit kushtetues.

7.3. Është e drejtë e ligjvënësimit të vlerësorë rast pas rasti nevojën e ndërhyrjes me anë të një rregullimi të ri. Në kundërshtim me sa pretendon kërkuarja, është e drejtë e organeve shtetërore të përcaktojnë tarifa për ofrimin e shërbimeve publike dhe, po ashtu, është e drejtë e shtetit të përcaktojë nëse ofrimin e një shërbimi publik do ta bëjë vetë, nëpërmjet organeve të tij publike apo do ta kryejë nëpërmjet një subjekti privat, që përzgjidhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit.

7.4. Pretendimi i kërkuar se kemi të bëjmë me një “mbi tatim” është i pavërtetë, pasi tarifa e vendosur paguhet për shërbimin e monitorimit *on-line* të lojërave të fatit dhe është në funksion të mirëmbajtjes dhe mirëfunksionimit të sistemit. Nisur nga ky arsyetim, pretendimi se është cenuar parimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike është i pabazuar, për rrjedhojë duhet rrëzuar nga Gjykata.

7.5. I pambështetur është edhe pretendimi i kërkuar se liria e veprimtarisë ekonomike është cenuar në mënyrë joproporcionale dhe në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, pasi ajo nuk ka paraqitur asnjë të dhënë konkrete në lidhje me kostot e ndërtimit e të mirëmbajtjes së SQMO-së në raport me tarifën e shërbimit. Këshilli i Ministrave jo vetëm ka ruajtur nivelin e vlerave të tarifave të propozuara, por ato janë rreth dy-tre herë më të vogla se niveli i propozuar.

7.6. Nisur nga fakti se kategoritë e lotarisë kombëtare dhe të kazinove elektronike kanë shumë njësi (makina, aparatura elektronike dhe operatorë), të cilat tarifohen secila individualisht çdo ditë, rezulton se janë këto dy kategori ato që paguajnë më shumë për monitorimin *on-line* sesa kategoritë e basteve sportive, e cila edhe pse paguan një tarifë ditore dhe një tarifë vjetore, në total paguan më pak se sa dy kategoritë e tjera.

7.7. Qëllimi i ligjvënësimit nuk ka qenë shkuarja përtej interesit të përgjithshëm, por domosdoshmëria e lindur në kuadër të informalitetit të lartë të evidentuar në këtë industri, evazionit fiskal, konkurrencës së pandershme, sistemit të padrejtë të taksimit, për krijimin e kuadrit të duhur ligjor për



zbatimin e një sistemi më të drejtë taksimi. Vetëm me ndërtimin e SQMO-së mund të krijohen mundësitë për të zbatuar kalimin nga një sistem taksimi bazuar mbi detyrime fikse për çdo pajisje, në një sistem taksimi bazuar në të dhënat e xhiros dhe të ardhurat bruto.

7.8. Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe, si i tillë, duhet të rrëzohet. Kërkesja nuk ka përcaktuar në mënyrë të saktë dhe të plotë se cili është shkaku mbi bazën e të cilit anëtarët e shoqatës diskriminohen në raport me subjektet e tjera të ligjit.

7.9. Bazuar në standardet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese subjektet e ligjit nr. 155/2015, të VKM-së nr. 647/2016 dhe të VKM-së nr. 331/2017 janë në kushte objektivisht të ndryshme, për rrjedhim nuk mund të trajtohen në mënyrë të barabartë.

7.10. Shërbimi i lojërave të fatit konsiderohet një aktivitet ekonomik i një natyre tepër të veçantë, me implikime dhe rreziqe tepër të larta për rendin publik dhe mbrojtjen e konsumatorit. Kjo veprimtari është e rregulluar në mënyrë tepër strikte nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së (përmes monopoleve ose lejimit të një numri të kufizuar operatorësh dhe shërbimesh), që kanë vendosur kufizime në lirinë e ofrimit të këtij shërbimi, me qëllim për të mbrojtur konsumatorin dhe rendin publik, të cilat janë pranuar edhe nga GJED-ja kur ato kanë qenë proporcionale dhe jodiskriminuese.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

8. Sipas nenit 131/1/a/c të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve normative me Kushtetutën. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*), Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134/2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, në cilësinë e “organizatave të tjera”, janë të specifikuar në nenin 134/1/h të Kushtetutës, si një ndër subjektet

që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta (*shih vendimin nr. 78, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134/1/h i Kushtetutës dhe neni 49/3/d, i ligjit nr. 8577/2000. Ajo është një subjekt juridik, regjistruar me vendimin nr. 3784, datë 4.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pra, është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

11. Po ashtu, kërkesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa për shfuqizimin e normave ligjore është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të përcaktuar në nenin 50/1 të ligjit nr. 8577/2000.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, sipas kërkesave të nenit 134/2 të Kushtetutës, kërkesja ka detyrimin të provojë interesin e saj në lidhje me çështjen, si dhe lidhjen e domosdoshme që ekziston ndërmjet misionit që ka dhe marrëdhënies juridike të cenuar nga dispozitat përkatëse të akteve normative të kundërshtuara. Sipas vendimit për regjistrimin e shoqatës dhe statutit të saj, qëllimi i krijimit është mbrojtja e interesave të shoqërive që operojnë në fushën e organizimit të lotove e basteve sportive dhe luajtja e një roli aktiv si përfaqësuese e interesave të anëtarëve të saj. Shoqata është krijuar nga 3 anëtarë themelues, të cilët janë: shoqëria “Xhoi Co 21” sh.a., shoqëria “T.T.S.G.A” sh.a. dhe shoqëria “Lottosport” sh.a. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson



se shoqata ka interes të drejtpërdrejtë për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, të së drejtës së pronës dhe parimit të proporcionalitetit, pretendime që si të tilla hyjnë në juridiksionin kushtetues.

13. Gjykata vëren se kërkuesja ka kërkuar shfuqizimin e shprehjes “*si dhe tarifën e mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit On-line që dubet të paguajnë shoqëritë e licencuara*” në nenin 48/2 dhe të shprehjes “*tarifa e mirëmbajtjes së tij që dubet të paguajnë shoqëritë e licencuara*”, në nenin 70/12. Referuar këtyre dy dispozitave rezulton se në thelb ato parashikojnë kompetencën e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kësaj tarife dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore në lidhje me to. Po ashtu, kërkuesja ka kundërshtuar edhe atë pjesë të VKM-së nr. 647/2016, e cila parashikon formulën e llogaritjes së tarifës që do të paguajnë shoqëritë e licencuara, si dhe pikën 1 të VKM-së nr. 331/2017, që miraton tarifën e mirëmbajtjes së SQMO-së sipas lidhjes së këtij vendimi.

14. Sipas nenit 131/1/c të Kushtetutës, Gjykata vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata ka theksuar se karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës që ushtron kjo Gjykatë, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimin nr. 36, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se këto akte nënligjore kanë karakter normativ, në kuptim të nenit 131/c të Kushtetutës, pasi i drejtohen të gjithë kategorisë së subjekteve tregtare që veprojnë në fushën e lojërave të fatit dhe efektet e tyre kanë karakter joshterues. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione materiae* për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe parimit të proporcionalitetit

15. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar liria e veprimtarisë ekonomike, si dhe parimi i proporcionalitetit, pasi subjektet anëtare të shoqatës ngarkohen padrejtësisht me tarifën për

shpenzimet operacionale që i duhen AMLF-së plus tarifën e shërbimit për një operator privat që do të kryejë monitorimin *on-line*.

16. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se pretendimi për kufizimin joproporcional të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës së pronës është i pabazuar, për faktin se situata aktuale e vlerësuar në lidhje me informalitetin e lartë në këtë industri, pasojat sociale negative etj. kërkojnë zbatimin e mekanizmave që përmbushin objektivat sociale dhe që nuk kanë si objektiv vetëm mbledhjen e të ardhurave.

17. Kushtetuta në nenin 11 të saj parashikon se sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur në mënyrë të vazhdueshme lidhur me kuptimin dhe rëndësinë e lirisë së veprimtarisë ekonomike, duke e përkufizuar atë si e drejta për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, e drejta për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, e drejta për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave. Po ashtu, liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje; lirinë e tregtisë ose mungesën e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve; lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmërinë e çmimit; lirinë fiskale për të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë; të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lira nga ndërhyrja e shtetit; lirinë e investimit dhe të qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj; lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror; lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimet nr. 17, datë 25.7.2008; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Përveç sa më sipër, liria e veprimtarisë ekonomike nënkupton edhe detyrimin e shtetit që



nëpërmjet legjislacionit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Ky detyrim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave disiplinohet ushtrimi i veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara, me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet, që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr. 28, datë 27.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për shkak të rolit aktiv të shtetit në drejtëm të ushtrimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike, hartuesit e Kushtetutës kanë parashikuar kriteret mbi bazën e të cilave mund të ndërhyhet për të rregulluar ushtrimin e kësaj të drejte. Neni 11, paragrafi 3 i Kushtetutës parashikon se “*kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kemi të bëjmë me kriterë që lidhen drejtpërdrejt me një liri konkrete, siç është ajo e veprimtarisë ekonomike. Nisur nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e kësaj dispozite është se ajo nuk përfshihet në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por gjendet e vendosur në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi shtetëror i vendit. Pra, hartuesi i Kushtetutës ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike, së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë dhe, së dyti, si pjesë e katalogut të lirive dhe të drejtave të shtetasve. Është pikërisht ky element dallues i kësaj lirie, pra qenia e saj si një nga shtyllat e shtetit demokratik, që i jep kësaj lirie një natyrë të veçantë. Kjo veçanti shprehet edhe në aspektin e parashikimit të kriterit kufizues në të njëjtën dispozitë që duhet të aplikohet në raste konkrete (*shih vendimet nr. 10, datë 19.3.2008; nr. 17, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Pavarësisht këtij kriteri kufizimi, duke qenë se Gjykata Kushtetuese e shqyrton pretendimin për cenimin ose jo të kësaj lirie të lidhur ngushtë me sferën e individit, ajo është e detyruar t'i drejtohet edhe përmbajtjes së nenit 17/1 të Kushtetutës, e cila shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të. Konkretisht, dispozita e nenit 17/1 parashikon se “*kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të*

tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.” Pra, kjo dispozitë, përveç arsyes publike, të cilën e gjejmë edhe te neni 11/3, përmban detyrimin për të respektuar edhe kriterë të tjera, si kufizimi me anë të ligjit dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë (*shih vendimin nr. 17, datë 27.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vlerëson se në ligjin nr. 155/2015 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij është parashikuar ngritja e Sistemit Qendror të Monitorimit On-line, i cili shërben për mbikëqyrjen në distancë dhe në kohë reale të organizatorëve që ushtrojnë aktivitetet në fushën e lojërave të fatit (AMLF-ja).

22. Gjykata, në kundërshtim me sa pretendon kërkuesja, vlerëson se është e drejtë e organeve shtetërore të përcaktojnë tarifa për ofrimin e shërbimeve publike dhe, po ashtu, është e drejtë e shtetit të përcaktojë nëse ofrimin e një shërbimi publik do ta bëjë vetë, nëpërmjet organeve të tij, apo do ta kryejë nëpërmjet një subjekti privat, që përzgjidhet nëpërmjet procedurave të konkurrencës.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se: “... ndërhyrja e shtetit nëpërmjet shënjjimit dhe monitorimit bëhet me synim shmangien e evazionit fiskal, kontrollin në cilësor të mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe disiplinimin e veprimtarisë në tregun e hidrokarbureve, si politikë shtetërore me interes publik. Gjithashtu, përveç qëllimit kryesor për të cilin Këshilli i Ministrave ka vendosur detyrimin e shënjjimit dhe monitorimit, ky proces ka edhe dobi të tjera me interes të përgjithshëm, si ngushtimin e hapësirave për veprime korruptive, përmirësimin e cilësisë së karburanteve, si dhe uljen e ndotjes ambientale. Për më tepër, duke qenë se procesi i shënjjimit dhe monitorimit është në tërësi instrument kontrolli kundër abuzimeve në sistemin fiskal, është në diskrecionin e ekzekutivit të vlerësojë nëse duhet të realizohet nga vetë shteti apo nga një subjekt i kontraktuar. Duke qenë shërbime specifike, që lidhen me realizimin e një interesi të përgjithshëm, Gjykata vlerëson se përjashtimi i tyre nga rregullat e konkurrencës nuk përbën cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr. 14, datë 21.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka paraqitur argumente apo referenca konkrete në lidhje me kostot e ndërtimit e të mirëmbajtjes së SQMO-së në raport me tarifat e shërbimit apo praktika të ngjashme nga vende të rajonit e më tej lidhur me rastin objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Nga ana tjetër,



subjektet e interesuara paraqitën një studim të organizatës ndërkombëtare UNDP, e cila, ndër të tjera, evidenton: “*Sigurimi i një sistemi qendror të monitorimit do të lejojë zbatimin dhe rregullshmërinë, duke siguruar që asnjë njësi, qendër, makinë apo individ të mund të vazhdojë aktivitetin e lojërave të fatit në mënyrë të pakontrolluar, përveç rasteve kur pajisjet e tyre janë të certifikuara nga subjektet përkatëse*”.

25. Gjykata vlerëson se detyrimi për të paguar tarifën e shërbimeve publike nuk nënkupton se jemi para kufizimeve, të cilat cenojnë lirinë e veprimtarisë ekonomike. Normat objekt gjykimi nuk përbëjnë rregullime materiale në fushën e lojërave të fatit, por përcaktojnë detyrimin për ngritjen e një sistemi monitorimi, i cili do të shërbejë për të kontrolluar veprimtarinë e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë fushë.

26. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, i sanksionuar në nenin 11 të Kushtetutës, është i pabazuar.

27. Në kushtet kur Gjykata vëren se nuk ndodhemi përpara cenimit të parimit të lirisë ekonomike, ajo çmon se edhe pretendimi i kërkuësës lidhur me cenimin e parimit të proporcionalitetit është i pabazuar.

28. Gjykata vlerëson se në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuësës për cenimin e parimit të mosdiskriminimit dhe të barazisë përpara ligjit, me pretendimin se nga dispozitat e ligjit rezulton se ndërmjet kategorive të lojërave të fatit ka dallime, si nga mënyra e organizimit të aktivitetit, të lojërave të fatit etj., këto kategori lojërash fati ndodhen në kushte objektive të ndryshme mes tyre dhe për këtë arsye pretendimet e kërkuësës janë haptazi të pabazuara dhe duhet të rrëzohen. Për rrjedhojë, Gjykata nuk mund të vijojë me analizën e mëtejshme të tyre.

29. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësës janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/a/c dhe 134/1/h të Kushtetutës, si dhe të neneve 49/3/d, 51, 51/a, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 51, datë 23.11.2017

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME DEVOLL

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Devoll me:

Drejtues ligjor: Elvis Hajderlli

Drejtues teknik: Edmond Shaholli

2. Operatori sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Devoll autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Devoll.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

**VENDIM****Nr. 52, datë 23.11.2017****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mirditë me:

Drejtues ligjor: Mark Leka

Drejtues teknik: Mark Leka

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mirditë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Mirditë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM**Nr. 53, datë 23.11.2017****PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME ROSKOVEC**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Roskovec me:

Drejtues ligjor: Admirand Stani

Drejtues teknik: Vilson Naçi

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Roskovec autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Roskovec.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM**Nr. 54, datë 15.12.2017****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KOLONJË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Kolonjë me:

Drejtues ligjor dhe drejtues teknik, z. Igli Radomi.

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Kolonjë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Njësia Administrative Ersekë (Bashkia Kolonjë).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1867, datë 15.11.2017, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Eldion Ndrio.

KËRKESE

Shtetasja Froso Memaj, e datëlindjes 13.7.1929, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë deklarin e vdekjes së shtetasit Edmont Memaj.

KËRKUES
Froso Memaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë